



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 703/5 Prot.

Tiranë, më 17/09/2018

**V E N D I M**

**Nr. 131, Datë 17/09/2018**

**PËR  
AUDITIMIN E USHTRUAR  
NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TIRANË, MBI "AUDITIMIN FINANCIAR DHE  
PËRPUTHSHMËRINË".**

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin Bujqësor, Tiranë, me objekt "*Auditim financiar dhe përputhshmërie*", për periudhën 01.01.2016 deri në 31.12.2017, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë jo materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërinë*", të ushtruar në Universitetin Bujqësor, Tiranë sipas programit të auditimit nr. 703/1, dt. 18.06.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Universitetin Bujqësor, Tiranë në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe (ISSAI 1700, dhe 4200) për të cilën do të japim opinion:

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në SUT krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, Raportimit Financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

### **Opinion:**

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Universitetin Bujqësor, Tiranë nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**<sup>1</sup>.*

### **Opinion:**

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

*“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Universitetit Bujqësor, Tiranë duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore”<sup>2</sup>.*

## B. MASA ORGANIZATIVE:

**B/1.** Gjetje nga auditimi aktual kryer në bazë të programit të auditimit nr. 703/1, datë 18.06.2018.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 dhe vitin 2017 rezultoi se Universiteti Bujqësor, Tiranë, financohet nga MASR me fonde buxhetore të pakushtëzuara, të cilat sipas kriterëve të ligjit nr. 80/2015, janë në dispozicion të Universitetit për t’i detajuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit. Në fakt fondet e çelura nga Ministria, të cilat Universiteti i ka detajuar dhe përdorur për të mbuluar kryesisht shpenzimet për fond page, sigurime shoqërore, bursa për studentët, mbulojnë rreth 75 % të këtyre zërave dhe pjesa tjetër rreth 25 % financohet nga të ardhurat dytësore.

<sup>1</sup> Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, *Konkluzionet/ opinionet e pakualifikuara*: Audituesi shpreh një konkluzion me kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë materiale dhe se auditimit është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit

<sup>2</sup> Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, “Audituesi duhet të shprehë një opinion të pakualifikuar për besueshmërinë e llogarive kur audituesi arrin në përfundimin që llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojnë atë opinion, ai/ajo duhet të konkludojë se ai/ajo ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Për sa më lart terminologjia për autonominë sipas ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3, ku përcaktohet se: “Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Bordi i Administrimit të Universiteti Bujqësor Tiranë, cakton në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit” nuk mund të zbatohet pasi Universiteti Bujqësor Tiranë, duke qenë se përfiton fonde buxhetore rreth 70 % të nevojave të saj. Përdorimi i fondeve buxhetore duhet të bazohet në VKM nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, më hollësisht trajtuar në, faqet 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

- UBT të marrë masat për rritjen e të ardhurave dytësore me qëllim përfitimin nga autonomia që rrjedh prej ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku Bordi i Administrimit të Universiteti Bujqësor Tiranë, të mund të caktojë në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.
- Përdorimi i fondeve publike nga buxheti i shtetit për institucionet e arsimit të lartë cili shpërndahet në formë granti duhet bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar; për politikat e zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, për mësimdhënien, punët kërkimore-shkencore dhe i veprimtaritë krijuese.
- UBT, nga të ardhurat e tyre të planifikojnë fonde për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtaritë krijuese, në raport me parashikimin e bashkëfinancimit, për të patur prioritet në përfitimin e fondeve grante nga buxheti i shtetit.

Në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Në analizën e zërave buxhetore konstatohet se, ka një planifikim jo real të shpenzimeve midis Programimit të shpenzimeve në projektbuxhetin afatmesëm PBA 2016-2018, planifikimit vjetor dhe çeljes së fondeve, konkretisht:

- Shpenzime transferta me jashtë, në PBA janë programuar në vlerën 1,625 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 1,855 mijë lekë, + 230 mijë lekë.
- Shpenzime për ndihmë ekonomike në PBA nuk janë programuar ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 1,097 mijë lekë.
- investime, në PBA janë programuar në vlerën 665 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2016 dhe çelja është në vlerën 1,700 mijë lekë, + 1,035 mijë lekë.
- Shpenzimet në paga për vitin 2017 në PBA janë programuar në vlerën 639,167 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 682,573 mijë lekë, + 43,573 mijë lekë.
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, janë programuar në vlerën 88,156 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 96,329 mijë lekë, + 8,173 mijë lekë.
- Bursa për studentët, janë programuar në vlerën 27,146 mijë lekë ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 35,000 mijë lekë, +8,854 mijë lekë.
- Shpenzime për ndihmë ekonomike në PBA nuk janë programuar ndërsa planifikimi për vitin 2017 dhe çelja është në vlerën 967 mijë lekë, më hollësisht trajtuar në, faqet 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-ve të sigurojë që, alokimet e buxhetit të reflektojnë prioritetet gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare), duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë midis alokimit të buxhetit dhe objektivave të politikës së programit, si dhe duke përcaktuar qartë prioritetet, objektivat, masat që do të merren për arritjen e këtyre objektivave si dhe kërkesat shtesë për secilin program buxhetor, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar; dhe pikës 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA”.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i të dhënave për realizimin e shpenzimeve rezultoi se investimet për vitin 2016 janë realizuar në masën 56 % dhe për vitin 2017 në masën 44% të planifikimit. Ky mosrealizim vjen si rezultat i moskryerjes së investimeve të planifikuara:

Për vitin 2016; shpenzime për pajisje laborator, pajisje për mbrojtje nga zjarri, pajisje për sistemin e sigurimit, orendi zyre, kafshë pune, pajisje kompjuterike. Gjithashtu janë kryer shpenzime të pa planifikuara për pajisje që sigurojnë energji.

Për vitin 2017; Shpenzime kërkime, studim e projektim, shpenzime për ndërtesë shkollore, shpenzime për pajisje laborator. Mos kryerja e investimeve të planifikuara është me efekte negative në gjenerimin e të ardhurave të institucionit, *më hollësisht trajtuar në faqet 13-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

Nga UBT të merren masat që në të ardhmen të planifikohen dhe të kryhen shpenzime për investime që gjenerojnë të ardhura me qëllim përdorimin e tyre për të rritur autonominë financiare të UBT-së në përcaktimin në mënyrë të pavarur të personelit, kriteret, procedurat e përzgjedhjes së tij, pagat e personelit dhe planifikimin e fondeve për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtaritë krijuese.

Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 210) “Toka troje terrene” për vlerën 0 lekë në një kohë kur ekzistojnë “troje” dhe “tokë arrë” të cilat janë regjistruar si pasuri me certifikatat përkatëse. Sipërfaqja totale e tokës që ka UBT në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.

Nuk janë pasqyruar në kontabilitet (“toka, troje e terrene”), vlerat e tokës truall dhe tokës arrë në administrim të UBT, prej 6,429,309,538 lekë, (Nga kjo truall 212,294 m<sup>2</sup> në vlerën 3,139,269,949 dhe tokë arrë 1,448,937 m<sup>2</sup> në vlerën 3,290,039,586 lekë) vlerë kjo e konsideruar materiale për auditimin e pasqyrave financiare, nga 0 lekë, sa pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet. *më hollësisht trajtuar në faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

Nga UBT të merren masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë **vlerësimin** e aktiveve (tokë, troje dhe terrene) në pronësi dhe administrim të UBT-së. Vlerësimet të kryhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e tokës nëpërmjet hartimit të dokumentacionit përkatës, planimetrive për sipërfaqet e tokave, hartat topografike dhe pasqyrimi në kontabilitetin e UBT-së duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar e të pavarur.

Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 211) “Pyje, kullota, plantacione” për vlerën 36,077 mijë lekë i zberthyer në mënyrë analitike në 11 objekte.

Nga analiza e zërave të llogarisë 211 rezultoi se një pjesë e tyre nuk pasqyrojnë emërtimin, përshkrimin dhe vlerën reale të aktivitetit si më poshtë:

-“Ambient përgjatë rrugës kryesore, fidanishte” në vlerën 1,798,671 lekë, të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

-“Ish vreshti, Kodër Kamzë” në vlerën 211,484 lekë i cili nuk ekziston më dhe sipërfaqja është zënë me ndërtime.

-“Kopsht botanik, Fidanë” (207 fidanë) në vlerën 64,610 lekë të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

-“Instituti i Mbrojtjes Bimëve, baza eksperimentale (Vreshti)”, në vlerën 76,780 lekë i cili është i degraduar pasi është mbjellë që në vitin 1978.

-“Ish stacioni i pemëtarisë Tiranë, Fidanë” (hardhi, ulliri, pemë frutore) në vlerën 233,495 lekë të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

UBT duhet të hartojë dokumentacionin përkatës, planimetritë për sipërfaqet e tokave, hartat topografike të përshtatë statusin e aktiveve dhe rivlerësojë ato bazuar në gjendjen aktuale të tyre, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Nga UBT të merren masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë rivlerësimin e aktiveve (Pyje, kullota, plantacione”). Rivlerësimet të kryhet në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdoret vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e pemëve, pemëtoreve, vreshtave, plantacioneve nëpërmjet hartimit të dokumentacionit përkatës, planimetrive për sipërfaqet e tokave, hartat topografike, përshtatja e statusit të aktiveve duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar e të pavarur.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 217) “Kafshë pune e prodhimi” në vlerën 3,053,350 lekë i zbrërthyer në mënyre analitike dhe përbëhet nga bletë, lopë, dele, desh, dosa harc e kuaj në vlerën 3,051,700 lekë me një diferencë nga vlera kontabël prej 1,650 lekë i rakorduar me inventarët e kryer.

Kafshët e punës dhe të prodhimit të UBT-së nuk janë pajisur me identifikimin e detyrueshëm individual sipas kërkesave të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” neni 6 : “Identifikimi i kafshëve të prodhimit”: 1. Gjedhi, delet, dhitë dhe derrat i nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm individual, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ministri. 4. Pronari i kafshëve është përgjegjës për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve sipas legjislacionit në fuqi, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Nga UBT të merren masat që kafshët e punës dhe të prodhimit në pronësi të institucionit të nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm individual, dhe regjistrimit të kafshëve sipas legjislacionit në fuqi. Pronari (UBT) është përgjegjës për njoftimin e lëvizjes së kafshëve, të cilat duhet të shoqërohen me certifikatë veterinare; mbajtjen e regjistrimit të identifikimit të kafshëve në fermë, sipas formatit të miratuar nga autoriteti kompetent, i cili ka të drejtën e kontrollit mbi të dhënat e regjistrimit në përputhje me legjislacionin përkatës.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 202) “studime dhe kërkime” në vlerën 12,654,004 lekë i zbrërthyer në mënyre analitike në këto nënzëra.

-Studime dhe kërkime në vlerën 12,515,804 lekë vlerë e pa përcaktuar se kush janë këto studime dhe kërkime.

- Dhënie “license nga ISHP”: në vlerën 20,000 lekë,

- “Rilevim dhe përpilim i planit topografik të territorit të UBT- së” në vlerën 118,200 lekë, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

- Nga UBT, Sektori i Financës të merren masa për të saktësuar vlerën e aktiveve “studime dhe kërkime”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara:



- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të UBT-së, për vitin 2018.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se “*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*” për 89,158 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të “*Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*”. Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor nuk është llogaritur për (Llog. 202) “*studime dhe kërkime*” dhe (Llog. 217) “*Kafshë pune e prodhimi*”.

**a.** Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” është përfshirë vlera e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 12,654,004 lekë. Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara. *Sa sipër nuk ka gjetur zbatim SKK nr. 5 të përmirësuar; “Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jomaterial në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi tjetër”.*

**b.** Gjithashtu për (Llog. 217) “*Kafshë pune e prodhimi*” në vlerën 3,053,350 lekë nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale*”, i përmirësuar, ku përcaktohet se: “*Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.*

Paragrafit nr. 107: “*Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”.*

“Amortizimi i AAGJ-së” është shpërndarja periodike dhe sistematike e vlerës së amortizueshme të AQT apo AP, në përputhje me jetëgjatësinë e dobishme. Jeta e dobishme ka të bëjë me periudhën gjatë të cilit ky lloj aktivi pritet të përdoret nga njësia apo numri i produkteve ose të ngjashme që njësia pret të përfitojë nga përdorimi i këtyre lloj aktiveve.

- Amortizimi në sektorin publik ka veçori, sepse nuk ka ndikim në shpenzime, por në fondet bazë të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

**c.** (Llog. 211) “*Pyje, kullota, plantacione*” për vlerën 36,077 mijë lekë është i zberthyer në mënyre analitike (*Fidana ulla në vlerën 14,693,984 lekë*). Pra si shikohet brenda tyre janë aktivet biologjike fidanë ulla në vlerën 14,693,984 lekë për të cilin duhet të llogarite amortizimi. Sipas SKK nr. 13, “*Aktivet biologjike janë kafshë ose bimë të gjalla, si bagëti, pemë dhe vreshta*”. Vlera kontabël neto është shuma, me të cilën një aktiv biologjik njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi). Amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një aktivi biologjik, përgjatë jetës së tij të dobishme, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

- Nga UBT, Sektori i financës të merren masat për përllogaritjen e amortizimit të aktiveve afat gjata materiale dhe jo materiale si konstatim kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të

pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.

- Për aktivet biologjike, kafshët ose bimët e gjalla, si bagëti, pemë dhe vreshta, të shpërndahet në mënyrë sistematike vlera e amortizueshme përgjatë jetës së tyre të dobishme dhe vlera kontabël neto të jetë është shuma, me të cilën një aktiv biologjik njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (*pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi*).

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Aktivet qarkulluese “llog. 34”, “Produkte” në shumën prej 5,896,140 lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe në analizë produkte të gatshme dhe nënprodukte në vlerën 5,246,231 lekë me një diferencë prej **649,909** lekë për këta ka inventar fizik të pa kuadruar me atë kontabël.

Aktivët qarkulluesë llog. 36, zëri “Gjë e gjallë në rritje e majmëri” në shumën prej 1,281,275 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc, në analizë përbëhet nga mëshqerra, mëzetër, rrurëza, gica, njëthundrakë të cilat janë në vlerën 1,282,040 lekë me një diferencë prej lekë **765** lekë dhe për këta ka inventar fizik i pa kuadruar me atë kontabël, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Rekomandojmë:**

- Nga UBT, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve qarkulluese, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të tyre:
- Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të UBT-së, për vitin 2018.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** “Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formati nr. 2 për vlerën 216,650 mijë lekë detyrime ku:

**a.** (llog. 411-418) “Klientë e llogari të ngjashme” zënë shumën 3,339 mijë lekë, Në analizë këta klientë përbëhen nga 16 subjekte për detyrim qira për objekte dhe shitje produktesh. Klientë të krijuar kryesisht në vitet 2016 dhe 2017. Klienti A.K (Shoqëria F...) ka detyrimin prej 1,007,118 lekë për kontratë shitje misër e krijuar nga viti 2004 dhe e pa arkëtuar. Gjithashtu edhe klienti Drejtoria e Trajtimit të Studentëve me vlerën 4,750 lekë për shitje qumësht e krijuar në vitin 2005 - 2006 e pa arkëtuar. Qendra e Policisë për detyrimin prej 6,000 lekë e krijuar nga viti 2008 e pa arkëtuar. (*Nga totali i detyrimit vlera prej 1,018 mijë lekë është pa shpresë arkëtimi*).

**b.** (Llog. 468) “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 54,300 mijë lekë e cila në analizë përbëhet nga 16 debitorë ku 7 debitorë me vlerën 46,370 mijë lekë janë debitorë të një periudhe mbi 8 vjeçare para vitit 2010. (*Nga kjo vlera prej 43,053 mijë lekë e cila përbëhet nga shuma e të ardhurave të konstatuara për tarifën e shkollimit të studentëve që nuk kanë frekuentuar shkollën për vitet 2007-2008 dhe 2008-2009 është konsideruar pa shpresë arkëtimi*), më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Rekomandojmë:**

Drejtesit e UBT-së duhet të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

Nga organet Drejtuese të UBT-së të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumave pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Shqyrtimi i llogarive të debitorëve (llog. 401-408) “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në vlerën 99,558 mijë lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolloam rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

E detajuar kjo llogari përbëhet nga 35 furnitorë krijuar nga viti 2008 deri 2017 në vlerën 16,362,401 lekë, 7 furnitorë nga projektet e huaja në vlerën 1.068,302 lekë, dhe 12 furnitorë të krijuar gjatë vitit 2017 në vlerën 82,126,364 lekë të likuiduara gjatë vitit 2018 me fondet e buxhetit 2017. *Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

Drejtesit UBT-së, në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të rishikojnë nëse janë marrë masat e nevojshme për njohjen reale të detyrimeve sipas standardeve të kontabilitet, për raste kur subjekti detyrohet që të transferojë përfitime ekonomike si rrjedhojë e transaksioneve ose ngjarjeve nga e kaluara. Me qëllim të shmangies së gabimeve, duhet të bëhet harmonizimi i llogarisë së kontabilitet me furnitorët duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

*Në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare është konstatuar se:

**a.** Në aktiv (llog. 520) “*Disponibilitete në thesar*” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 234,457,060 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur që trashëgoohen për vitin 2018 në pasivin e bilancit është paraqitur në llogaritë; *që përbëhen nga të ardhura të pa përdorura në vlerën 147,759,027 lekë kryesisht nga projekte të huaja, garanci punimesh (Llog. 466), në pasiv prej 3,872,298 lekë, dhe fatura të papaguara në vlerën 82,825,738 lekë*

Llogaria “*Disponibilitete në thesar*”, në mënyrë të përmbledhur duhet të përfaqësojë në debi: fondet periodike të akorduara nga shteti (subvencione e financime), subvencione apo financime për të tretë, arkëtimet faktike të çdo të ardhure, çdo derdhje nga të tretët që ka të bëjë me veprimtarinë e shitjes, derdhjet e të ardhurave nga arka, tërheqjen e kësteve nga llogaritë në organizma krediti e financiarë. rastet eventuale të xhirimeve nga llogaria bankare në llogarinë e thesarit, pjesën e fondeve buxhetore të papërdorura, arkëtimet nga mjetet në ruajtje.

**b.** Vlera prej 229,867,605 lekë e kontabilizuar në llogaritë (nr. 85) “*Rezultati ushtrimor nga funksionimi*” *i denatyrton këto llogari* dhe vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “*Detyrimet afat shkurtër*” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër specifiku të analizuar sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” dhe “*Llogari të tjera*” që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor, kryesisht 476 “*Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur*”.

**c.** Nga UBT është mbajtur akti i rakordimit me degën e thesarit mbi të ardhurat për vitin 2017 ku janë cilësuar të ardhurat që mbeten për tu trashëguar në vlerën 105,654,854 lekë *pa emërtimin e burimit dhe llogarisë nëse janë nga grantet të ardhura tjera, sponsorizime, grant nga organizatat e huaja dhe pa relacionet shpjeguese të pasqyrave financiare, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

- Nga UBT sektori i financës të merren masat që periodikisht tepricat e llogarisë 520, “*Disponibilitete në thesar*” dhe të llogarisë 466, “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” duhet të vërtetohen me aktrakordimet me degën e thesarit, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. *Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*



- Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës dhe si tepricë debitore, kjo llogari duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

Në vijimësi

**13. Gjetje nga auditimi:** Në strukturën organizative të Rektoratit të UBT-së, Dega e Mësimit, Kurikulave dhe Vlerësimit Institucional, Dega e Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve, Dega Juridike, Dega e marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, Zyra e Studimeve dhe Studentëve, Zyra e Mësimit dhe Zhvillimit të Kurikulave, Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, Zyra e Shkencës dhe Kooperimit Shkencor, Zyra e Promovimit të Gradave, Zyra e Marrëdhënieve me Biznesin, Qendra e Zhvillimit të Karrierës, janë drejtuar nga personel akademik, të cilët përveç pagesës për mësimdhënie kanë përfituar pagesë suplementare 8% deri në 10% të pagës, në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, konkretisht ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 16, ku citohet “Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit”.

Për periudhën maj 2017 deri në dhjetor 2017, me vendimmarrjen e tyre, Rektorati i Universitetit, Senati Akademik, Bordi i Administrimit kanë kapërcyer kompetencat që ju jep legjislacioni i sipër cituar, duke sjellë përdorimin pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore në vlerën 674,733 lekë, më hollësisht trajtuar në faqet 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Universiteti Bujqësor i Tiranës, të marrë masa për zëvendësimin e drejtuesve të drejtorive apo sektorëve, që drejtohen nga personel akademik i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme, të cilët në zbatim të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku janë të punësuar.

Menjëherë

#### **14. Gjetje nga auditimi:**

**14.1** Paga e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, për vitin akademik 2015-2016 dhe 2016-2017, në Universitetin Bujqësor të Tiranës është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i ndryshuar.

Urdhri nr. 101, datë 18.07.2016, i Rektorit të Universitetit, pa vendim marrje të Bordit të Administrimit, në kundërshtim me legjislacionin e sipërcituar, ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të stafit akademik pa miratimin nga MASR si dhe kryerjen e pagesës së plotë mbi normën vjetore, nga 70% deri në 100%. Paga e të stafit akademik nga 70% deri në 100% të orëve mbi normën vjetore për vitin akademik 2015-2016, ka sjellë përdorimin pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore në vlerën në vlerën 8,034,140 lekë.

**14.2.** Kancelari, në mungesë të vendim marrjes së Rektoratit të Universitetit, Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 dhe Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në tejkalim të kompetencave dhe detyrës së tij funksionale, ka nxjerrë urdhrin nr. 142, datë 25.07.2017 “Mbi trajtimin financiar të mbingarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë, të sistemit me kohë të

*pjeshme dhe personelin akademik” ku urdhëron për trajtim financiar 100 %, të mbingarkesës mësimore të realizuara nga personeli akademik, për vitin mësimor 2016-2017.*

Nxjerrja e urdhrit nr. 142, datë 25.07.2017, nga Kancelari i Universitetit, ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të stafit akademik pa miratimin nga MASR si dhe kryerjen e pagesës së plotë mbi normën vjetore nga 70% deri në 100%. *Pagesa e stafit akademik nga 70% deri në 100% të orëve mbi normën vjetore për vitin akademik 2016-2017, ka sjellë përdorimin pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore në vlerën 8,358,673 lekë, më hollësisht trajtuar në, faqet 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### **Rekomandojmë:**

Universiteti Bujqësor i Tiranës, të marrë masa të menjëhershme që trajtimin financiar të mbingarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë, të sistemit me kohë të pjeshme dhe personelin akademik, të kryhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të urdhrave të Kancelarit nr. 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, dt. 28.09.2017 “Për kryerjen e inventarëve fizikë për të gjitha njësitë e UBT-së” nga komisionet e ngritura është kryer inventarizimi i plotë i pasurisë së UBT-së, duke ju referuar gjendjes kontabile të datës 31.08.2017 për të gjitha njësitë dhe gjendjes të dt. 30.09.2017 për kryerjen e inventarizimit në magazinën nr. 1 të UBT-së dhe jo për periudhën e plotë ushtrimore deri me datën 31 Dhjetor, e cila duhet të reflektohej në pasqyrat financiare të periudhave ushtrimore.

Ky inventar ka përfunduar në datën 20.10.2017 dhe të gjitha të dhënat janë pasqyruar në fletët e inventarit të cilat janë firmosur nga personi materialisht përgjegjës dhe anëtarët e komisionit. Gjithashtu nga komisionet e verifikimit ngritur me urdhrin nr. 202, dt. 03.11.2017 janë hartuar pasqyra përmbledhëse kontabël, fizike si dhe materialeve jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit si dhe materialet për tu nxjerrë jashtë përdorimit të verifikuara në vlerën 32,588,213 lekë.

Nga komisionet e inventarizimit janë kryer inventarizimet duke bërë krahasimet me gjendjen kontabël sipas llogarive përkatëse ku kanë rezultuar diferenca në vlerën **1,504,200** lekë të cilat janë miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 17, dt. 12.10.2017 për tu ndjekur procedurat ligjore për një makinë Benz Sel 5000 me targë TR 3247 D, me vlerën kontabël 1,504,200 lekë dhe të kalojnë në humbje vlerat 156,883 lekë për kafshët e dëmtuara llog. 217. *Për vlerat e mësipërme nuk janë kryer veprimet në kontabilitet dhe të paraqiten si detyrime ose humbje duke i nxjerrë nga inventari.*

Gjithashtu nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në datën 30.11.2017 është hartuar relacioni mbi verifikimin e materialeve (Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 202, dt. 03.11.2017) të relatuara për jashtë përdorimit në vlerën **32,588,213** lekë dhe materialeve stok në magazinë nr. 1, në vlerën **464,599** lekë të UBT-së drejtuar kancelarit, i cili rekomandon që ky material ti paraqitet për miratim Bordit të Administrimit. *Procedura nuk ka vazhduar më tej dhe materiali përkatës nuk i është drejtuar Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim, më hollësisht trajtuar në, faqet 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### **Rekomandojmë:**

- Nga UBT, të merren masat që inventarizimi i aktiveve të bëhet për vitin e plotë ushtrimor, me qëllim pasqyrimin e saktë dhe real të vlerës së inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të subjektit, në përputhje me të Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011.
- Drejtuesit e UBT-së Bordi i Administrimit të marrin masat për të shqyrtuar vlerën e aktiveve të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe materialeve stok në magazina.
- Në rast miratimi nga Bordi i Administrimit nga sektori i financës, të bëhet reflektimi, në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe/ose asgjësimin e tyre nga komisionet

përkatëse si ngjarje të ndodhura në periudhën e raportimit financiar si një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

- Për diferencat e inventarëve në vlerën 1,504,200 lekë të cilat janë miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 17, dt. 12.10.2017 të kryhen veprimet në kontabilitet, të paraqiten si detyrime dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre.
- Gjithashtu rregullimi i shumave të njohura në pasqyrat financiare, duhet të shoqërohen, me dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për ngjarjet rregulluese për periudhën raportuese.

*Në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimeve u konstatua:

**a.** Për të gjithë tenderat e audituar, NJP-të nuk kanë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse. Mos kryerja e këtij është në kundërshtim me LPP, Kreu II, neni 12 “*Përgjegjësia e autoritetit kontraktor*”, pika 3, si dhe VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 64.

**b.** Dosjet e procedurave të prokurimeve nuk janë të inventarizuara në mënyrë të rregullt si dhe nuk janë arkivuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*”, mangësi e cila vështirëson dhe nuk bën të mundur auditimin e dokumentacionit sipas radhës kronologjike kohore të kryerjes së tyre, *më hollësisht trajtuar në, faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

- Titullari i AK, të marri të gjitha masat për të ardhmen, që para se të lidhen kontratat me fituesit e tenderave, të nxjerrë urdhrin për NJP për ti kontrolluar të gjitha praktikat dokumentare të paraqitur fizikisht me ato të raportuara në platformën elektronike të faqes së APP-së dhe të dokumentojnë marrjen e tyre në dorëzim nga OE fitues i tenderit, konform legjislacionit të prokurimeve.
- Të merren masat nga UBT për inventarizimin në mënyrë të rregullt dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimeve në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*”.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Në Universitetin Bujqësor, Tiranë (UBT), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së, *më hollësisht trajtuar në, faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

UBT, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “*Njësia e Prokurimit*” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur efikasitetin, ekonomikitetin dhe efektivitetin në procedurat e prokurimit publik.

*Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës sipas deklaratës doganore SAD ose datës sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “*taksa e markimit*”.

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....” pika 5 dhe 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”, më hollësisht trajtuar në faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Nga UBT në zbatimin e kontratave dhe likuidimin e vlerës së mallrave të furnizuara të merren masat si vijon:

- Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës dhe me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës.
- Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas deklaratës doganore SAD, aportheve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

*Në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Për vlerën e furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me furnitorët mundëson edhe pagesa të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë dhe të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare, më hollësisht trajtuar në pikën II/c faqe 22-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Drejtimesit e UBTT, në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të rishikojnë nëse janë marrë masat e nevojshme për njohjen reale të detyrimeve sipas standardeve të kontabilitetit. Me qëllim të shmangies së gabimeve, duhet të bëhet harmonizimi i llogarisë së kontabilitetit me furnitorët duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

*Në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formatu 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar, relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Rekomandojmë:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me pyetësorët dhe relacionin shpjegues për pasqyrat financiare ku të përfshihen të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

*Në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Universiteti Bujqësor, Tiranë nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së tij, si një mënyrë konkrete përmes së cilës UBT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here programin e transparencës. Në faqen zyrtare në [web](#) mungon publikimi, informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së UBT-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen



zyrtare i cili duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatet kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin, ku çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë.

Faqja zyrtare e UBT-së nuk mundëson për publikun informacionin pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve, subjekteve të të dhënave, etj. Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014, dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, më hollësisht trajtuar në, faqet 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Rekomandojmë:**

UBT të hartojë, miratojë programin e transparencës dhe në përputhje me të, të ndërtojë faqen zyrtare në **web**, duke vendosur në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit, në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e informacionit mbi:

*Strukturën organizative të UBT; Tekstet e plota, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij; Informacionin për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike; Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të UBT-së, orarin e punës; Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë; Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi UBT-në, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjerat; Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit; Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat; Informacion për shërbimet që UBT i ofron publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm; UBT-ja, gjithashtu, duhet të krijojë dhe arkivojë një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës; Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta.*

*Menjëherë*

***B/2. Gjetje nga auditimi i zbatimit të detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme në UBT me shkresën nr. 956/9, dt. 30.04.2014.***

Nga auditimi i ushtruar në zbatim të programit të auditimit u konstatuan raste të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH nga auditimi i mëparshëm, me shkresën nr. 956/9, dt. 30.04.2014 ku rezultojnë të pa zbatuara:

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontabilitetit rezultoi debitorë në shumën **94,596 lekë** punonjësja J.L në vitin 2000, pikë shitje për libra shkollore, shumë e cila pretendohet të jetë derdhur nga punonjësja po në vitin 2000, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është mbajtur dhe regjistruar në librat përkatës debitorë dhe shuma për tu shlyer, pa ndjekur procedurat ligjore për vërtetimin nëse ky arkëtim është kryer ose jo, më hollësisht trajtuar në, faqet 72-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Rekomandojmë:**

Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **94 596 leke** pikë shitje për libra shkollore, shumë e cila pretendohet të jetë derdhur nga punonjësja J.L në vitin 2000 dhe është lënë e pa sistemuar nga ana kontabël, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

*Menjëherë*

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua së në dy raste, në vitin 2012 dhe vitin 2013, administrata e Rektoratit nga të ardhurat e UBT, ka shpërblyer në vlerën neto 1,416,911 lekë punonjësit e saj, pasi janë angazhuar si drejtues të zyrave ndihmëse të Rektoratit, dhe si të tillë kanë bërë të mundur funksionimin normal dhe me efikasitet të plotë të zyrave që ata drejtojnë



duke qenë njëkohësisht edhe pedagog me ngarkesë të plotë, duke përdorur si referencë ligjore VKM nr.720, datë 29.11.1995, “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”, vendim i cili më 01.06.2012 është shfuqizuar me VKM nr. 418, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësisve të qeverisjes qendrore”, më hollësisht trajtuar në, faqet 72-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Rekomandojmë:**

Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit prej **1,416,911 lekë** nga 8 punonjësit e institucionit, si përfitim të padrejtë.

Menjëherë

### **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

**Gjetje e konstatime me dëm ekonomik në vlerën 2,418,050 lekë.**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punimet e ndërtimit me objekt “Rikonstruksioni i objekteve ndërtimore në UBT” rezultoi se për fillimin e punimeve është mbajtur procesverbal i datës 27.10.2017 me përfaqësuesit e operatorit ekonomik, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i UBT me prot. 1488/122, dt. 30.10.2017.

Nga sipërmarrësi i punimeve “N” shpk dhe mbikëqyrësi i punimeve “H” shpk është mbajtur procesverbal i dt. 28.10.2017 mbi volumet e punimeve që shtohen dhe hiqen brenda preventivit me argumentin se “...me marrjen e projektit të zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i objekteve ndërtimore në UBT” bëmë verifikimin e volumeve të punimeve të paraqitura në projekt, ballafaquar me situatën faktike në vend, krahasimin e tyre me volumet e paraqitura në preventiv, si dhe atë të punimeve të ndryshme që dalin të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës”. Nga verifikimi në objekt të volumeve të paraqitura në projekt-preventivin e objektit rezultoi se kemi ndryshime të volumeve të punës (punime që shtohen 25 = **1,690,261 lekë** dhe punime që hiqen 26 = **1,530,950 lekë** nga 124 zëra punimesh gjithsej, janë ndryshuar 41% e zërave). Ky procesverbal nuk është firmosur ose miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor për këto ndryshime. Ky procesverbal është shoqëruar edhe me tabelën e ndryshimit të volumeve (preventiv i rishikuar në vlerën 14,700,397 lekë me tvsh) edhe ky i pa miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Këto ndryshime zërash punimesh janë bërë në datën 28.10.2017 kur kontrata e lidhur është në datën 27.10.2017 e prot dhe po në këtë datë kanë filluar edhe punimet. Ndryshimi i zërave të preventivit nuk ka ardhur si rezultat i zbatimit të punimeve ku mund të konstatohet ndryshimi i volumeve.

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar pikat 3.1, “ .....Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv. Gjithashtu është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu I, pika 7 (7.1, 7.2, 7.3)

7. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.

7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj.

7.2 Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës.

7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.

Nga verifikimi i zërave të situacionuar krahasuar me preventivin e punimeve të ofertuar dhe miratuar rezulton se janë kryer zëra punimesh shtesë jashtë preventivit të pa miratuara në vlerën **1,690,261** lekë pa tvsh të cilat janë me efekte financiare në fondet publike dhe duhet të arkëtohen nga operatori ekonomik “N” sh.p.k, më hollësisht trajtuar në, faqet 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Rekomandojmë:**

Nga UBT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,690,261** lekë nga subjekti “N” sh.p.k. pasi gjatë zbatimit të kontratës “Rikonstruksioni i objekteve ndërtimore në UBT” ka situacionuar zëra punimesh të pa miratuara nga autoriteti kontraktor që ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të preventivit dhe kontratës duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, vlerë e cila duhet të arkëtohet.

*Menjëherë*

**25. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil nga UBT, me Urdhër shpenzimin nr. 465, dt. 18.10.2017 në vlerën 4,719,946 lekë me tvsh dhe Urdhër shpenzimin nr. 84, dt. 16.03.2017 në vlerën 3,600,000 lekë me tvsh. të furnizuar nga subjekti “A” sh.a. rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave referuar deklaratave doganore SAD, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, ku si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit ka sjellë pagesë të tepërt në vlerën **727,789** lekë e cila duhet të arkëtohet, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, më hollësisht trajtuar në, faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Rekomandojmë:**

Nga UBT, sektori i finanës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **727,789** lekë nga OE “A” sha. përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, referuar deklaratave doganore SAD, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Menjëherë*

**D. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

*Gjetje për fonde të trajtuara pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën **32,787,212** lekë.*

**26. Gjetje nga auditimi:** Në strukturën organizative të Rektoratit të UBT-së, disa drejtori apo sektorë, janë drejtuar nga personel akademik, të cilët përveç pagesës për mësimdhënie kanë përfituar pagesë suplementare 8% deri në 10% të pagës, në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 16, ku citohet “Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit”.

Për periudhën maj 2017 deri në dhjetor 2017, me vendimmarrjen e tyre, Rektorati i Universitetit, Senati Akademik, Bordi i Administrimit kanë kapërcyer kompetencat që ju jep legjislacioni i

*sipër cituar, duke sjellë përdorimin pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore në vlerën 674,733 lekë, më hollësisht trajtuar në, faqet 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Rekomandojmë:**

UBT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **674,733** lekë.

*Menjëherë*

**27. Gjetje nga auditimi:**

- Rektorit të Universitetit me Urdhrin nr. 101, datë 18.07.2016, pa vendim marrje të Bordit të Administrimit, ka urdhëruar kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të stafit akademik pa miratimin nga MASR si dhe kryerjen e pagesës së plotë mbi normën vjetore, nga 70% deri në 100%. Pagesa e stafit akademik nga 70% deri në 100% të orëve mbi normën vjetore për vitin akademik 2015-2016, ka sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit në vlerën 8,034,140 lekë.

- Kancelari i Universitetit me Urdhrin nr. 142, datë 25.07.2017 “Mbi trajtimin financiar të mbingarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë, të sistemit me kohë të pjesshme dhe personelin akademik”, ka urdhëruar kryerjen e pagesës për orët mbi normën vjetore (nga 30% deri në 70 %) të stafit akademik pa miratimin nga MASR si dhe kryerjen e pagesës së plotë mbi normën vjetore nga 70% deri në 100%. Pagesa e stafit akademik nga 70% deri në 100% të orëve mbi normën vjetore për vitin akademik 2016-2017, ka sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit në vlerën 8,358,673 lekë.

Kryerja e pagesave të stafit akademik nga 70% deri në 100% të orëve mbi normën vjetore për vitin akademik 2016-2017 në vlerën 16,392,813 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i ndryshuar ka sjellë përdorimin pa eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore, më hollësisht trajtuar në, faqet 41-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Rekomandojmë:**

UBT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **16,392,813** lekë.

*Menjëherë*

**28. Gjetje nga auditimi:** Për tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”, me urdhrin nr. 12, dt. 21.07.2017 është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për kryerjen e rikonstruksionit të objekteve ndërtimore për UBT për vitin 2017. Ky grup pune me shkresën nr. 1488/1, dt. 21.07.2017 ka përgatitur preventivin me zërat e punimeve me sasi të përkatëse pa çmimet për njësi dhe vlerat përkatëse pa përcaktuar fondin limit për rikonstruksionin e objekteve ndërtimore në UBT megjithëse ky komision shprehet se fondi limit është **15,719,666** lekë pa tvsh. Gjithashtu nuk ka një projekt të hartuar me planimetritë përkatëse për punimet për çdo objekt që do të ri konstruktohej mbi bazën e të cilit do të dilnin edhe zërat e punimeve.

- Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, pika 2, Njësia e prokurimit është përgjegjëse për: “përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”; “përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”;

- Është vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar:

- **pika 3.1**, “Preventivat e objekteve ..... të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit

nga Këshilli i Ministrave”..... . “Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv” .

- **kreu 1, pika 4 dhe 5**, sipas të cilave: .... Personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit janë: investitori; sipërmarrësi; mbikëqyrësi i punimeve. Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm: ..... c) Projektin e zbatimit të firmosur nga projektuesi .....”.

Projekti i zbatimit përmban: .....projektin e plotë konstruktiv, së bashku me relacionin teknik shpjegues;..... Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit .....” më hollësisht trajtuar në faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Rekomandojmë:**

UBT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficensë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **15,719,666** lekë.

Menjëherë

### **E. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, Rregullores si dhe Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, referuar përshkrimin të punës dhe detyrave që mbulojnë në strukturat përkatëse, i rekomandojmë Rektorit dhe Administratorit të UBT: të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” deri në “Largim nga puna” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi:

#### **A. Autoriteti kontraktor:**

1. R.M, ish, kancelari i UBT.

#### **B. Njësia e prokurimit;**

2. K.B, juriste,
3. S.S, inxhinier,
4. M.M, ekonomiste.

#### **C. Grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike;**

5. S.S, inxhinier
6. A.K,
7. L.L,

#### **Për shkeljet e konstatuara:**

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”, me urdhrin e ish kancelarit R.M nr. 12, dt. 21.07.2017 është ngritur grupi i punës (S.S, A.K, L.L), për argumentimin e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për kryerjen e rikonstruksionit të objekteve ndërtimore për UBT për vitin 2017.

Ky grup pune me shkresën nr. 1488/1, dt. 21.07.2017 miratuar nga ish. Kancelari ka përgatitur preventivin me zërat e punimeve me sasi të përkatëse pa çmimet për njësi dhe vlerat përkatëse pa përcaktuar fondin limit për rikonstruksionin e objekteve ndërtimore në UBT megjithëse ky komision shprehet se fondi limit është 15,719,666 lekë pa tvsh.

Gjithashtu nuk ka një projekt të hartuar me planimetritë përkatëse për punimet për çdo objekt që do të ri konstruktohej mbi bazën e të cilit do të dilnin edhe zërat e punimeve.

Nga Njësia e Prokurimit prokurimit K.B, juriste, S.S, inxhinier, M.M, ekonomiste, me procesverbalin nr. 1, dt. 28.07.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 12, dt. 02.08.2017 janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, operatorët e ftuar (fondi limit dhe *specifikimet teknike si dhe kriteret teknike janë përcaktuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 12, dt. 21.07.2017*) mungon projekti i hartuar me planimetritë përkatëse për punimet për çdo objekt që do të ri konstruohet mbi bazën e të cilit do të dilnin edhe zërat e punimeve, mungon preventivi i punimeve të rikonstruksionit me vlerën limit me sasi të, çmimet dhe vlerat përkatëse.

Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 “Kontratat për punët publike”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

## **F. MASA ADMINISTRATIVE:**

Bazuar në ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, bazuar në germenin “c” dhe “ç”, të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar, Nenin 3 pika 2, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit në Akt Konstatimin nr. 3 të mbajtur gjatë auditimit, (protokolluar në UBT me nr. 1366/4, datë 17.07.2018) **i propozojmë** Komisionit të Posaçëm për Dhënien e Licencave Profesionale, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që në funksion të nenit 41 pika ç dhe pikës 3/a për shkelje të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë, të analizojë dhe të japë masë:

### **Për subjektet:**

- Operatorin “N” sh.p.k përfaqësuar nga X.N, sipërmarrës i punimeve të ndërtimit “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”;
- Operatorin “H” s.h.pk. përfaqësuar nga ing. F.B, mbikëqyrës i punimeve të ndërtimit “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”;

### **Për shkeljet e konstatuara:**

#### **Në zbatimin e punimeve të ndërtimit “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”,**

Midis operatorit “N” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1488/16, datë 27.10.2017 për rikonstruksionin e objekteve ndërtimore në UBT me vlerën 12,250,331 lekë pa t.v.sh. ose 14,700,397 lekë me tvsh me afat të kryerjes së shërbimit brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 28.11.2017).

Nga sipërmarrësi i punimeve “N” sh.p.k dhe mbikëqyrësi i punimeve “H” sh.p.k. është mbajtur procesverbali i dt. 28.10.2017 mbi volumet e punimeve që shtohen dhe hiqen brenda preventivit me argumentin se “...me marrjen e projektit të zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i objekteve ndërtimore në UBT” bëmë verifikimin e volumeve të punimeve të paraqitura në projekt, ballafaquar me situatën faktike në vend, krahasimin e tyre me volumet e paraqitura në preventiv, si dhe atë të punimeve të ndryshme që dalin të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës”. Nga verifikimi në objekt të volumeve të paraqitura në projekt-preventivin e objektit rezultoi se kemi ndryshime të volumeve të punës (punime që shtohen 25 = 1,690,261 lekë dhe punime që hiqen 26 = 1,530,950 lekë nga 124 zëra punimesh gjithsej, janë ndryshuar 41% e zërave).



Ky procesverbal nuk është firmosur ose miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor për këto ndryshime. Ky procesverbal është shoqëruar edhe me tabelën e ndryshimit të volumeve (*preventiv i rishikuar në vlerën 14,700,397 lekë me tvsh*) edhe ky i pa miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Këto ndryshime janë bërë në datën 28.10.2017 kur kontrata e lidhur është në datën 27.10.2017 e prot dhe po në këtë datë kanë filluar edhe punimet. Ndryshimi i zërave të preventivit nuk ka ardhur si rezultat i zbatimit të punimeve ku mund të konstatohej ndryshimi i volumeve. (Nga UBT nuk ka projekt të hartuar për “Rikonstruksioni i objekteve ndërtimore në UBT”). Punimet e zbatimit janë kryer pa pasur një projekt.

Sa më lart është vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar pikat 3.1, “ .....Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.

Gjithashtu është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kreu I, pika 7 (7.1, 7.2, 7.3)

7. Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.

7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj.

7.2 Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës.

7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.

Për sa më lart gjykojmë se kanë përgjegjësi sipërmarrësi i punimeve “N” sh.p.k, përfaqësuar nga X.N, mbikëqyrësi i punimeve “H” shpk përfaqësuar nga ing. F.B dhe Autoriteti kontraktor UBT të cilët kanë lejuar dhe kryer punime në zërat jashtë volumeve të preventivuara dhe pa projekt.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**